




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria Komunale e Arsimit/Odeljenje za Obrazovanje/Department of Education

REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje



-IV- Nr. i prot. 637 Më 26.01.2021
Br. prot. Dt. 2021
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 8, Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011, neni 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it. Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativ për Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

Konkurs

Për plotësimin e 8 vendeve të lira të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2020/2021:
Mësues/e klase, për Program Fillor.

Kushtet për konkurrim:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A.10/2018, Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm), ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e çertifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.

Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret /shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>

Lista Pritëse:

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 50 pikë, hynë në Listën pritëse si kandidat fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë -Mësues/e klase, kanë të drejtë të punësohen. Lista pritëse vlen vetëm gjatë vitit 2021.

Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës .

Aplikimi në konkurs:

Afati i aplikimit fillon nga data 26.02.2021 dhe zgjat 15 ditë kalendarike dhe atë deri me datë 12.03.2021, deri në ora 16.

Rahovec,
26.01.2021



Avni Morina, Drejtor

Avni Morina